NJË KËRKIM RRETH TË DHËNAVE HISTORIKE MBI KULLËN E SAHATIT DHE JETËGJATËSINË E KËTIJ OBJEKTI

RILINDASI

Suplement i SHQIPTARJA.com

E diel
31 maj 2015
Viti IV - **Nr:**73
E-mail: rilindasi@gmail.com
Kryeredaktore;
Admirina Peçi

KALAJA E KANINËS

Misteri i kullës së sahatit, ja gjurmët e mbetura në dokumente

NGA DRITAN ÇOKU



Në Shqipërinë Jugperëndimore një nga fortifikimet e rëndësishme mesjetare është edhe Kanina e ngritur në një kodër 379 m. të lartë. Ndonëse muret e qytetit të fortifikuar të Kaninës ndjekin trasenë e periudhës antike, formën dhe pamjen në gjendjen që trashëgojmë sot, ai e mori përgjatë mesjetës. [1] Në vitin 1530 kalaja rindërtohet nga sulltan Sulejmani, ndërsa ndërtimet e fundit të shek. XVII-XIX i përkasin përpjekjeve të feudalëve shqiptare të Vlorës për të rimëkëmbur këtë fortifikim. [2]

Për kalanë e Kaninës na informon udhëpërshkruesi osman Evlija Çelebi në shek. XVII duke përshkruar nga portat e kalasë, fortesën e brendshme, xhaminë e mbuluar me tjegulla që e cilëson me një minare të bukur dhe pallatin e Gazi Sinan Pashës afër saj...[3] (fig.1)

Në fillim të shek.XIX, si Leake [4] më 9 dhjetor 1804 ashtu edhe Pouqueville [5] më 1807 e përshkruajnë kalimthi kalanë e Kaninës dhe fshatin me të njëjtin emër. Më 1812 kalaja ra në duart e Ali pashës. [6] Kalaja e Kaninës e lënë pas dore si fortifikim që nga viti 1832 iu nënshtrua shkatërrimeve të herëpashershme. [7] Në gjendje të mjerueshme e gjetën ushtarët turq në gusht të vitit 1848 kur erdhën për të shtruar kryengritjen kundër Tanzimatit. Këtë na e vërteton edhe kënga popullore: "Atje, në limën në Vlorë, tre karadhe e dy pampor, prunë nizam edhe tabor, zunë kalan që ish bërë horr!"[8] Më 21 tetor 1848 në kalanë e Kaninës ngjitet edhe artisti anglez Edëard Lear [9] ku realizon një vizatim në të cilin duket mjaft mirë kulla e sahatit....

vijon në faqen 18-19

Festivali Foklorik i Gjirokastrës, vlerat e nëpërkëmbura

Një vështrim kritik rreth disa dukurive që u vërejtën në fetivalin më të rëndësishëm të muzikës folklorike shqiptare, mbajtur në Gjirokastër nga 10-16 maj 2015...

NGA VLASH PRENDI

Më në fund edhe evenimenti më i rëndësishëm folklorik mbarëkombëtarë përfundoi. Përfundoi aktiviteti më i madh që promovon ritmikisht në çdo 5-vjet kërkimet dhe vlerat e këngës dhe valles burimore mbarëkombëtare shqiptare, për të cilin pak u interesuam, pak kontribuam dhe akoma më pak punuam. Ishte një festival vlerash, gjetjesh, përsëritjesh, mungesash dhe prapaskenash, për të cilin organet përkatëse sidomos Ministria e Kulturës, apo Instituti i Antropologjisë duhej të ishin menduar më mirë. Mirë duheshin programuar edhe paraqitjet dhe komisionet përzgjedhëse në rrethe, pasi për të organizuar një festival si ky yni që e ka zanafillën që nga viti 1968. ...

faqe 22



L I S T E

der albanischen Delegierten, welche an der Nationalversammlung zu Valona, am 28. November 1912, teilgenommen haben.

Für Valona : Ismail Kemal Bey Vlora, zugleich als Vorsitzender der der Versammlung ; Ekrem Bey Vlora (abwesend, in Himarä), Djazim Kokoschi, Zihni Nuri Effendi Kanina, Lehrer Johann Mingo, Aristidi Kutzi ;

Für Argyrokastro : Veli Effendi, Elmas Effendi und Aziz

Für Tepeleni : Pjeter Logoreci

Für Berat : Ali Bey Frasheri (abwesend), provisorisch: Midhat Bey Frasheri ;

Für Elbasan : Ismail Effendi (abwesend), provisorisch : Dimitri Zografi und Pandeli

Für Durazzo : Turkan Bey Permeti (abwesend), provisorisch : Dimitri Zografi und Pandeli

Für Kavaja : Ismail Effendi (abwesend), provisorisch : Dimitri Zografi und Pandeli

Für Tirana : Essad Bey Toptani (abwesend), Midhat Bey Frasheri ;

Für Durazzo : Turkan Bey Permeti (abwesend), provisorisch : Dimitri Zografi und Pandeli

Für Kavaja : Ismail Effendi (abwesend), provisorisch : Dimitri Zografi und Pandeli

Für Tirana : Essad Bey Toptani (abwesend), Midhat Bey Frasheri ;

Für Kortscha : Themistokli Germenji, Jedoch aus Kortscha gebürtig ;

Für Fieri : Mehmed Bey Vrioni (abwesend), Elias Bey Vrioni,

Für Berat : Turkan Bey Permeti (abwesend), Elias Bey Vrioni,

Für Mallakastra : Ismail Bey Tepelena (abwesend), Kemal Bey Vrioni

Für Lusnja : Ismail Bey, Rebi Effendi

Imzot Nikollë Kaçorri, 98 vjet nga ikja e atdhetarit dhe arkitektit të Pavarësisë

Është lënë gjithnjë në heshtje, me gjithëse ka qenë, përkrah Ismail Kemal Vlorës, edhe ndënkryetar i denjë i së parës qeveri shqiptare, i zgjedhun prej nj´atij Kuvendi Kombëtar qi shpalli pavarsinë e Atdheut

NGA PJETER LOGORECI

faqe 20-21

Kristi Gjezi, fisniku i ri i violinës në skenat botërore

Fitues i katër çmimeve ndërkombëtare të fituara në Francë, Zvicër, Spanjë, Moskë. Gazeta "Le Marseillais", në nëntor 2013, cilësonte se ky violinist 23-vjeçar do ketë një të ardhme të ndritur


NGA INA KOSTURI

Violina si instrument studiohet në moshë fare të vogël. Krenohen muzikantët me koncertet e para në një garë shpejtësie, talenti e sfide me veprat, kompozitorët e rëndësishëm e më pas me studimet në Konservatorët e shkollat prestigjioze të artit. Debutojnë suksesshëm në skenë, përjetojnë emocion e duartrokitje. E vetëm disa ndjekin ëndrrën e gjithë violinistëve të famshëm, lavdinë që japin në mënyrë speciale dhe të padiskutueshme konkurset e rëndësishme ndërkombëtare, udhërrëfyeset e suksesit të instrumentistëve. Ata më të mirët, që përballojnë e nisin një karrierë ndërkombëtare marrin pjesë në këto evenimente të botës muzikore, të njohura ....

faqe 23

GJURMËVE | HISTORIKE


Foto e vjetër "kulla e sahatit e kalasë së Kaninës"


Kalaja e Kaninës 21 tetor 1848: Biblioteka Houghton, Universiteti i Harvardit

KALAJA E KANINËS

Kulla e sahatit, ja dëshmitë e rrënimit të saj

Jetëgjatësia e saj mund të ketë qenë shumë e shkurtër vetëm disa vjet nga koha e ndërtimit deri tek shkatërrimi i saj më 1850. Ja gjurmët e mbetura në komumentet e kohës..

NGA **DRITAN ÇOKU**

vijon nga faqja 17


...(fig.2). Ky është dokumentimi i parë deri më sot i kullës së sahatit. Më 28 tetor, siç shprehet Lear "përpara se dielli të fundosej poshtë..." [10] ai realizon edhe dy vizatime të tjera nga Kanina. Në njërin prej këtyre dy vizatimeve të realizuara, kulla e sahatit si ndërtim arkitektonik mbi kullën fortifikuese është shumë i lexueshëm (fig.3). Por, me hyrjen edhe me qëndrimin e ushtarëve turq deri më 1850, kalaja u shkatërrua edhe më tepër, sepse kur dolën morrën me vete topat e fundit edhe prishën gjithë godinat që qëndronin ende në këmbë. Mendojmë se këtë fat mund të ketë pësuar edhe kulla e sahatit. Jetëgjatësia e saj mund të ketë qenë shumë e shkurtër vetëm disa vjet nga koha e ndërtimit dhe shkatërruar më 1850.

Ky është fakti që albanologu Han (1854) si studiues, por edhe si një dëshmitar okular nuk e përmend kullën e sahatit në kalanë e Kaninës, ndonëse përshkruan hollësisht planin e kështjellës krahasimisht me ato të Akrokorintit, të Patrasit dhe fortesat e tjera të këtyre viseve, por njëherazi përshkruan edhe për banesat e familjes së sundimtarit dhe i cilëson gërmadha.[11] Nga një vizatim i vitit 1884 realizuar nga drejtori i minierës së Selenicës Ing. Barthélemy ku ka paraqitur kalanë e Kaninës në aksonometri (fig.4) ambjenti i këmbanës i kullës së sahatit nuk duket. [12]


Më 1891 kulla e sahatit në kalanë e Kaninës u meremetua dhe në të u vendos "sahati i Kaninës", i ardhur nga Gjermania. Me interes të veçantë është shënimi në trokën e saj, ku thuhet se ajo i ishte dhuruar kishës (Shën-Onufrit të Kaninës) nga Gjergj Arianiti. [13] Edhe Eqrem bej Vlora në librin e tij "Kalaja e Kaninës dhe shkrime të tjera" na informon se "nga banesa që kishte ngritur Zejnel pasha, kishe mbetur në këmbë deri në vitin 1919, një kullë gjysmë e shkatërruar; më 1891 u meremetua edhe u vendos në të sahati i katundit të Kaninës". Më pas ai vazhdon: "pas ushtarëve turq (1850) shtatëdhjetë vjet pas kësaj kalaja mbeti në dorë të zotit dhe mëshirë të njërëzve, deri sa, më 1916 e zuri ushtria italiane. Mbeturinat, që mundnin ende të pasqyronin diçka gjendjen e mëparshme, kjo ushtri nuk i mbrojti, pa dashur i zhduku. Më së fundi, në korrik të vitit 1919, e bombardoi kalanë edhe, kot së koti e rrënoi krejt". [14] Një dëm të konsiderueshëm kalaja e Kaninës pësoi prej bombardimit italian me artileri të rëndë gjatë Luftës së Vlorës, si dhe shembjes së një pjese të saj nga trupat xheniere. [15] Këmbana e kullës së sahatit ishte zhdukur pas bombardimit që pësoi kalaja në vitin 1920 (qershor) nga ana e flotës italiane. Thonë që është ruajtur në shtëpinë e Selman Delos, në Kaninë. [16]

TË DHËNA TEKNIKO-ARKITEKTONIKE

Kulla e sahatit në kalanë e Kaninës (fig.5), ashtu si kullat e sahatit në Elbasan dhe Prezë kanë të veçantën e tyre sepse ato janë të ndërtuara mbi kulla fortifikuese, kuptohet kur këto të fundit e humbin cilësinë e plotë si kullë fortifikuese kalaje. Mbi kullën e gurtë (5,60 m) streha e së cilës është me dy pllaka guri pas një mbulese me flet plumbi me pendencë dhe lartësi 0,5 m lartësohej ambjenti i këmbanores 1,3 m me katër kolona prej druri. Këto kolona kufizohen




Kanina 28 tetor 1848: Biblioteka Houghton, Universiteti i Harvardit



Planimetria e kalasë së Kaninës e vitit 1688, punuar nga Vincenzo Coronelli: Biblioteka Kombëtare Marciana - Venecia




Kulla e sahatit pas shkatërrimit


Kulla e Sahatit para shkatërrimit

NË FOTO:
Vizatimi i Ing. Barthélemy viti 1884

në mënyrë perimetrale nga një paturë prej druri, duke të dhënë përshtypjen e dritares me hark. Në pjesën e harkuar mjeshtrat tanë popullor kanë realizuar një dekoracion të thjeshtuar, por duke futur gjëra vetiake në këtë drejtim ata kanë pasuruar vlerat estetike të saj. Ky ambjent mbulohej me një çati me konstruksion druri ku forma piramidale me bazë katrore me lartësi 0,5 m mbulohej me fletë plumbi. Pra, kulla e sahatit mendojmë se ka qenë 7,90 m, ndërsa nga tabani i kullës gjashtëkëndore e cila ka një lartësi të ruajtur 7 m [17] ajo zhvillohej në vertikalitet deri 15 m e lartë (fig.6 skicuar nga Dritan Çoku). Planimetria e kullës së sahatit është katrore ku trashësia e muraturës prej guri është 0,75 m. Qoshet e kullës së sahatit janë realizuar me gurë të punuar. Sot ajo ruhet në gjendje rrënoje (fig.7 skicuar nga Dritan Çoku).

Kulla e sahatit si një kategori arkitektonike, që reflekton kushtet ekonomiko-shoqërore, duke i materializuar këto si konceptim, ashtu edhe në teknikën e materialin e përdorur, përbën për historinë e arkitekturës sonë mesjetare një kapitull të veçantë. [18]

BIBLIOGRAFIA

1- Apollon Baçe, Qyteti i fortifikuar i Kaninës, "Monumentet" 7-8, 1974, Tiranë: Mihal Duri, f.32

2- Gjirak Karaiskaj, Pesë mijë vjet fortifikime në Shqipëri, Tiranë: 8 Nëntori, 1981, f.167

3- Muhamet Dhil-li Ibni Dervishi (Evlija Çelebi), Shqipëria para tre shekujsh, Enciklopedi shqiptare e mesjetës, botim i plotë, Tiranë: Besa, 2000, f.69

4- Ëilliam Martin Leake, Travels in Northern Greece, Vol 1, London: J.Rodëell, Neë Bond Street, 1835, p.2

5- F.C.H.L. Pouqueville, M.D., Travels in Epirus, Albania, Macedonia and Thessaly, London, 1820, p.13

6- Eqrem bej Vlora, Kalaja e Kaninës dhe shkrime të tjera, Tiranë: Koçi, 2004, f.23

7- Apollon Baçe, Qyteti i fortifikuar i Kaninës, "Monumentet" 7-8, 1974, Tiranë: Mihal Duri, f.39

8- Eqrem bej Vlora, Kalaja e Kaninës dhe shkrime të tjera, Tiranë: Koçi, 2004, f.25

9- Edëard Lear, Journals of a Landscape Painter in Albania and Greece, London: Richard Bentley, 1851, p.218

10- Po aty, f.292

11- Johan Georg fon Hahn, Studime shqiptare, Tiranë: ID&K, f.106

12- Shih fig. 6a Eqrem bej Vlora, Kalaja e Kaninës dhe shkrime të tjera, Tiranë: Koçi, 2004, f.8

13- Zija Shkodra, Esnafët Shqiptarë (shek.XV-XX), Tiranë, 1973, f.44

14- Eqrem bej Vlora, Kalaja e Kaninës dhe shkrime të tjera, Tiranë: Koçi, 2004, f.25-26

15- Apollon Baçe, Qyteti i fortifikuar i Kaninës, "Monumentet" 7-8, 1974, Tiranë: Mihal Duri, f.39

16- Eqrem bej Vlora, Kalaja e Kaninës dhe shkrime të tjera, Tiranë: Koçi, 2004, f.10

17- Apollon Baçe, Qyteti i fortifikuar i Kaninës, "Monumentet" 7-8, 1974, Tiranë: Mihal Duri, f.36

18- Sulejman Dashi, Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë, Monumentet 12, 1976, Tiranë: Mihal Duri, 1976, f.105